



Pranuar / Dorezuar Prijmjeno / Predato Received / Delivered	28 - 12 2020	0	viti god year
Organ / Rreza Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SAMSAT	3319/2020		13



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.351/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Hysni Mustafa - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A. nr.351/2020 të parashtruar me datë 11.11.2020 nga ankuesi [REDACTED], me adresë fshati Ruboc, Komuna e Lipjanit, kundër organit të punësimit Ministria e Financave/Thesari i Kosovës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.12.2020, mori këtë::

### V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.351/2020 e datës 11.11.2020 e parashtruar nga ankuesi [REDACTED]
- II. MBETET në fuqi Vendimit me Nr.27/2020 i datës 20.10.2020 i Komisionit Disiplinor të Thesarit të Kosovës.

### A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED], i punësuar sipas akt emërimit të datës 28.03.2012 në pozitën "Udhëheqës Divizioni" në Sektorin e Operimeve, në Departamentin e Thesarit në Ministrinë e Financave.

Me datë 20.09.2020, përmes e-malit zyrtar, Zëvendësuesja e Drejtorit të Thesarit, znj. [REDACTED] Zv. Drejtore e Operimeve, ka kërkuar nga Komisioni Disiplinor që të fillohet procedurë disiplinore ndaj ankuesit, me supozimin për tejkalimin e procedurave për dhënien e autorizimeve të disa zyrtarëve nga Ministria e Infrastrukturës nga ana e z. [REDACTED] nëpunës i ankuesit.

Komisioni Disiplinor i Thesarit të Kosovës, me datë 20.10.2020, nxjerr vendimin me numër prot. Nr.27/2020, me të cilin ankuesin e pezullon nga marrëdhënia e punës.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.27/2020 të datës 20.10.2020 të Komisionit Disiplinor të Thesarit të Kosovës, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.11.2020 ka parashtruar ankesë më numër protokolli 2542/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike dhe vendosjes në mënyrë meritore ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:2542/2020 të datës 11.11.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emali i datës 23.10.2020; Ankesa ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor të Thesarit të Kosovës; Emali i datës 09.11.2020; Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 20.10.2020; Kërkesa për përgjigje e datës 17.11.2020; Përgjigja në kërkesë e datës 30.11.2020; Emali zyrtar i datës 10.12.2020; Emali zyrtar i datës 20.10.2020; Akt emërimi i ankuesit i datës 28.03.2012; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën-udhëheqës i divizionit menaxhimi financiar, i datës 01.10.2008; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Menaxher i Tavolinës ndihmëse i datës 30.01.2013; Rregullorja (QRK) Nr.6/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Thesarin e Kosovës; Kërkesa për qasje të përdoruesve në SIMFK e datës 04.01.2016; Vendimi i datës 25.08.2020 për themelimin e Komisionit Disiplinor të Thesarit të Kosovës; Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 20.10.2020; Shkresa e datës 20.10.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit ██████████ është e pa bazuar, *sepse*:

Komisioni Disiplinor i Thesarit të Kosovës pasi që ka marr kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit më datë 20.10.2020 ka nxjerr Vendim me Nr.27/2020 me të cilin ka bërë pezullimin e marrëdhënies së ankuesit duke ju referuar Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht nenit 48 paragrafit 5 i cili përcakton se: *“Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar”*. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar se Vendimi me Nr.27/2020 i datës 20.10.2020 i Komisionit Disiplinor të Thesarit të Kosovës për „Pezullim nga marrëdhënia e punës” ndaj ankuesit nuk është vendim përfundimtar lidhur me rastin e ankuesit por është vendim i ndërmjetëm i cili do të mundësojë Komisionit Disiplinor të konstatojë saktë dhe drejt gjendjen faktike sepse rasti për të cilin është iniciuar procedura disiplinore është ndjeshëm dhe është në procedurë hetimore edhe nga Policia e Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pa u lëshuar në shkeljet e supozuara të ankuesit të cilat janë theksuar në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, vlerëson se pezullimi marrëdhënies së punës së ankuesit është bërë me qëllim që rasti si i ndjeshëm të trajtohet me shumë kujdes dhe me profesionalizëm, rrjedhimisht për këtë masë komisioni disiplinor ka kompetencë respektivisht ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 48 paragrafit 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë

dhe nenit 13 paragrafit 6 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamentin Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
Lënda me numër A.nr.351/2020

Hysni MUSTAFA

*por*  
*Belit*

Procesmbajtës

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit [REDACTED]
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Thesarit të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

